

Nr. 638/2 Prot.

Tiranë, më 02.04.2026

**VENDIM**

Nr. 32, datë 02/04/2026

**PËR**

**MIRATIMIN E KANDIDATURAVE QË PLOTËSOJNË KRITERET PËR KONKURSIONIN  
“ADMINISTRATOR I UNIVERSITETIT TË ARTEVE”**

Mbështetur në nenin 51, pika 2 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Statutin e Universitetit të Arteve, i ndryshuar, shpalljen në Buletinin nr. 17, datë 02.03.2026 të Agjencisë së Prokurimit Publik, shkresën nr. 638/1 prot., datë 30.03.2026, me lëndë: “Relacion mbi verifikimin e dosjeve të kandidatëve për pozicionin Administrator në Universitetin e Arteve”, Senati Akademik i Universitetit të Arteve, pas bisedimeve,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e kandidaturës së z. Adriatik Kraja, si kandidat që plotëson kriteret e përcaktuara dhe të shpallura publikisht për konkursin për pozicionin: “Administrator i Universitetit të Arteve”.
2. Ky vendim t’i përcillet menjëherë Bordit të Administrimit të Universitetit të Arteve.
3. Ky vendim të publikohet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve.

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE**

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Arben LLOZI



Prof. Najada HAMZA

Prof. Miltiadh KUTALI

Prof. Sadik SPAHIJA



Prof. Lorenc RADOVANI



Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Endri SINA

Prof. Rudina CIKO



Prof. Gazmend GJOKA



Prof. Asoc. Dorian ÇENE



Prof. Asoc. Albes FUSHA



Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI




Prof. Asoc. Kristina LAÇO



Prof. Asoc. Genci FUGA



Prof. Asoc. Alert ÇELOALIAJ




Prof. Asoc. Orion SHIMA

Enea TRIMI (Student FAB)



Rei KITA (Student FM)



Nr. 638/1 prot.

Tiranë, më 30/03/2026

**Lënda:** Relacion mbi verifikimin e dosjeve të kandidatëve për pozicionin Administrator në Universitetin e Arteve

### SENATIT AKADEMIK

**Tiranë**

Në zbatim të Vendimit të Senatit Akademik në Universitetin e Arteve Nr. 30, datë 26/03/2026, shprehur nëpërmjet shkresës Nr. 638 prot., datë 26/03/2026 *Për ngritjen e grupit të punës për verifikimin e dosjeve të kandidatëve që plotësojnë kriteret për pozicionin "Administrator në Universitetin e Arteve"*, grupi i punës i përbërë nga Prof. Asoc. Dorian Çene, Prof. Asoc. Albes Fusha dhe Prof. Asoc. Alert Çeloaliaj ka realizuar verifikimin e përmbajtjes së dosjeve të kandidatëve të paraqitur.

Lidhur me gjetjet e grupit të punës për secilën prej dosjeve të shqyrtuara ju bëjmë me dije si më poshtë vijon:

- Në përfundim të verifikimit të dokumentacionit të dorëzuar nga kandidatja znj. Elisa Bërziu, rezulton se, referuar kriterëve të shpallura nga Agjencia e Prokurimit Publik, me Buletinin Nr. 17, datë 02/03/2026, *Njoftim për vend të lirë pune në Universitetin e Arteve në pozicionin Administrator i Universitetit të Arteve, Kriteret Kualifikuese*, nuk plotësohet kriteri i parashikuar në pikën 1, sipas të cilit kandidati duhet të ketë minimalisht mesataren 8 (tetë). Metodologjia e ndjekur nga grupi i punës për vlerësimin e mesatares së përgjithshme është bazuar në shumatoren e të gjitha notave (për lëndët që janë vlerësuar me notë, sikurse dhe diploma) përpjestuar me numrin e lëndëve. Kriteri i mësipërm, në shpalljen e pozicionit të sipërpërmendur të punës, parashikohet si skualifikues.

- Në përfundim të verifikimit të dokumentacionit të dorëzuar nga kandidati z. Adriatik Kraja, rezulton se, referuar kriterëve të shpallura nga Agjencia e Prokurimit Publik, me Buletinin Nr. 17, datë 02/03/2026, *Njoftim për vend të lirë pune në Universitetin e Arteve në pozicionin Administrator i Universitetit të Arteve*, janë plotësuar të gjitha Kriteret Kualifikuese, sipas parashikimeve të pikave 1, 2, 3, sikurse dhe është paraqitur dokumentacioni në përputhje me kërkesat e shpalljes.

Për Grupin e Punës

**Prof. Asoc. Dorian Çene**

**Prof. Asoc. Albes Fusha**

**Prof. Asoc. Alert Çeloaliaj**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I ARTEVE

**SKEDË INFORMATIVE PËR KANDIDATËT KONKURUES NË UART**

SKEDA Nr. Adriatik Bedri Kruja  
(Emri, Atësia, Mbiemri)

1. Datëlindja: 22/07/1977
2. Diplomimi i kandidatit: Ekonomist i drejtimit të fermave dhe agrosivnesitëz
3. Specializime te ndryshme, nëse ka : Kontabil i Minutave
4. Pozicioni që konkuron : **ADMINISTRATOR NË REKTORATIN E UART**

**Plotësimi i kriterëve :**

1. Kërkesa /letër motivimi	✓
2. Diplomë + listë notash mesatare përgjithshme mbi 8 (Juridik/Ekonomik)	✓
3. Vjetërsi në punë në këto fusha mbi 10 vjet (3 vite drejtues )	✓
4. Të mos ketë lidhje/konflikt interesi me : Drejtuesit e UART, Bordin e Administrimit, Drejtues ne MA	✓
5. Jetëshkrim CV	✓
6. Referencë pune nga ish/punëdhënësi	✓
7. Formulari i vetëdeklarimit DAP	✓
8. Dëshmi e gjuhës së huaj	✓
9. Paraqitja e Platformës	✓





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

10. Çertifikatë/trajnim,kualifikim	✓
11. Dëshmi e gjëndjes gjyqësore/ vetedeklarim	✓
12. Dëshmi e gjëndjes mjeksore	✓

13. Përfundime :

KOMISIONI I VLERËSIMIT TË DOSJES

1. Prof. Assoc. Donich Cera
2. Prof. ASC. ALBES FUSTA
3. Prof. Assoc. Alad Shalraj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I ARTEVE

**SKEDË INFORMATIVE PËR KANDIDATËT KONKURUES NË UART**

SKEDA Nr. Elisa Halim Benziv  
(Emri, Atësia, Mbiemri)

- Datëlindja: 17/10/1988
- Diplomimi i kandidatit: DIPLOM - Administrim Biznes-Marketing (2013)
- Specializime të ndryshme, nëse ka: Microsoft Office Specialist Health Management
- Pozicioni që konkuron: ADMINISTRATOR NË REKTORATIN E UART

*Training on Health Systems and Sustainable Financing*

**Plotësimi i kriterëve :**

- |   |  |
|---|--|
| 1. Kërkesa /letër motivimi  | ✓  |
| 2. Diplomë + listë notash mesatare përgjithshme mbi 8 (Juridik/Ekonomik)                                  | ✓<br><i>Nuk plotëson kriterin e notës mesatare</i> |
| 3. Vjetërsi në punë në këto fusha mbi 10 vjet (3 vite drejtues )  | ✓  |
| 4. Të mos ketë lidhje/konflikt interesi me :<br>Drejtuesit e UART, Bordin e Administrimit, Drejtues ne MA | ✓  |
| 5. Jetëshkrim CV  | ✓  |
| 6. Referencë pune nga ish/punëdhenësi   | ✓  |
| 7. Formulari i vetëdeklarimit DAP   | ✓  |
| 8. Dëshmi e gjuhës së huaj  | ✓  |
| 9. Paraqitja e Platformës   | ✓  |





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

10. Çertifikatë/trajnim,kualifikim	✓
11. Dëshmi e gjëndjes gjyqësore/ vetedeklarim	✓
12. Dëshmi e gjëndjes mjeksore	✓

13. Përfundime :

Kandidatja Elisa Benazi nuk plotëson kriterin kualifikues parashikuar në pikën 1 (një) të kriterave kualifikuese.

KOMISIONI I VLERËSIMIT TË DOSJES

1. Prof. Asoc. Donika Cene
2. Prof. Asoc. ALBES FUSTA
3. Prof. Asoc. Alaud Chalouj

